



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 116, Datë 16/07/2014

Bazuar në nenin 32, pika 3 dhe nenin 33, të Ligjit 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenin 85, pika 3, të Kodit të Proçedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N :

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e znj. [Emri i personit], me Nr. 29 rregj., datë 10.04.2014, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat (DRSKSH).

Sipas shpjegimeve të dhëna, znj. [Emri i personit] sqaron se ka punuar në DRSKSH-në Berat, prej 15 vitesh, në pozicione të ndryshme pune. Marrëdhëniet e punës në këtë institucion, kanë nisur në vitin 1999 dhe kanë vazhduar pa ndërprerje, deri më datë 31.01.2014. Nga viti 1999 deri në vitin 2002, ka punuar si ekonomiste pranë DRSKSH-së Berat. Më pas, në vitet 2002-2006, ka ushtruar detyrën e Shefes së Sektorit të Statistikës në këtë institucion. Në vitin 2006, është emëruar në detyrën Zv/Drejtores të DRSKSH-së Berat, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 23.10.2013. Me anë të urdhërit nr. 189, datë 23.10.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, z. Astrit Beci, është liruar nga detyra e Zv/Drejtorit dhe është emëruar si specialiste ekonomiste në Sektorin Spitalor në DRSKSH-në, Berat. Ka mbajtur këtë detyrë deri më datë 31.01.2014, kur me anë të urdhërit nr. 1, datë 31.01.2014, të Drejtorit të këtij institucioni, z. [Emri i personit], është zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontrata e punës dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare. Znj. [Emri i personit] në ankesën e saj pretendon se, për shkak të qënies pjesë e listës emërore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike, për Qarkun e Beratit, në zgjedhjet e kaluara, është pushuar nga puna që mbante në DRSKSH-në Berat.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Për marrjen e informacionit dhe provave, mbi lëvizjet e personelit, vlerësohet i domosdoshëm administrimi i procedurave të ndjekura nga ana në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Berat (DRSKSH).

Duke patur parasysh se verifikimi i fakteve të pretenduara nga znj. Nevila Hyska, është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes, bazuar në nenin 85, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- Pezullimin e procedimit administrativ të çështjes së znj.
- Ky vendim përfundon pas administrimit të provave dhe fakteve për zgjidhjen e ankesës.
- Ngarkohet Drejtoria e Hetim-Inspektimit dhe Inspektori që ndjek çështjen për zbatimin e këtij vendimi.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al